

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

UJESJELLES-KANALIZIME SH.A- SARANDE

Sarande, me 13.10.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për : “MANE/S” Sh.p.k

NIPT J64103865K

Procedura e prokurimit : Kerkese per propozim

Numri i references se procedures : REF-70482-09-02-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës : “NDERTIM STACION I RI PUS-ÇPIMI NE VRION DHE LIDHJA ME RRJETIN KRYESOR TRANSMETUES”

Fondi limit : **11.880.279** (njembedhjetemilion teteqind tetedhjetemije e dyqind e shtatedhjete e nente) leke pa tvsh

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit : çmimi më i ulët

Publikime të mëparshme : **Buletini i Njoftimeve Publike nr. 66, date 8 Shtator 2020**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “COGREN” shpk	NIPT J74818825K	me oferte 9,172,603 (leke pa TVSH)
2. “MANE/S” shpk	NIPT J64103865K	me oferte 9,404,900 (leke pa TVSH)
3. “Shendelli” shpk	NIPT K07924803N	me oferte 9,637,301 (leke pa TVSH)
4. “K.M.K” shpk	NIPT L78223801E	me oferte 10,710,320 (leke pa TVSH)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te 4(kater) OE qe kane paraqitur oferte ekonomike, rezultoi se 2 prej OE nuk i plotesonin kerkesat dhe kushtet e DST-se te hartuar nga AK.

Nga sa me siper KVO-ja konkludoi se:

1. Operatori Ekonomik COGREN shpk

Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

1. Per Piken 2.2.1

Nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga OE “COGREN” shpk rezulton se:

Shoqeria “COGREN” ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 2.2.1 per punët e ngjashme.

1. Furnizim Vendosje Pompa per Depon Lekures”.
2. “Linja e ndriçimit rrugor me llamba ekonomike”.
- 3.”Punime per Shpime Pusi dhe Furnizim me uje Fermeri”.
4. “Linja e Re Ujesjellsi Piqeras Shkalle(Malesoret).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne brendësi rezulton se:

Per Objektin Nr.4. **“Linja e Re Ujesjellsi Piqeras Shkalle(Malesoret).** OE “COGREN” ka realizuar si nenkontraktor kete objekt, por rezulton se OE ka **kaluar vlerën 40%** te nenkontraktimit si kusht ligjor i percaktuar ne **Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 47/2017 Neni 62 Pika 2**

Se pari kjo kontrat publike e realizuar me nenkontraktim nga OE, eshte ne shkelje te kriterëve dhe neneve te percaktuar ne ligjin e mesipërm, te cilën Bashkia Himare ka lejuar kete nenkontraktim ne kundërshtim me ligjin.

Se dyti, Nisur dhe nga përcaktimet e ligjit, KVO merr ne konsiderat si pune te realizuar per Objektin nr.4 (Ujesjellsi piqeras shkalle) vetëm 40% te vlerës totale te kontratës baze te cilën e ka lidhur Kontraktori “Karl Gega” shpk me Bashkine Himare.

Nga sa me sipër, nëse mbledhë vlerat e kontratave te rregullta te realizuar Objekti nr.1, Objekti nr.2, Objekti nr.3 dhe 40% te vlerës per Objektin Nr,4, **nga qe Ligji vetëm 40% te vlerës se kontratës lejon,** këto shuma nuk e arrijnë vlerën prej 23,760,558 lek pa TVSH te percaktuar ne **piken b) te kriterit ligjor 2.2.1** te hartuar nga AK, **(Ku vlera totale puneve te kryera e marre sebashku gjate tre viteve te fundit, te jete sa dyfishi i vlerës limit te kontratës qe prokurohet, pra 27,760,558 lek pa TVSH.**

Per sa me sipër vlera totale e punëve te kryera nga ky OE, duke marre 40 % te vlerës per Objektin Nr.4 eshte, :

Objekti Nr.1- 4,777477 lek pa TVSH (depo lëkurës) + Objekti Nr.2-8,222,222 lek pa TVSH(Linjat e ndriçimit) + Objekti Nr.3- 4,453591 lek pa TVSH (Pusi Fermerit) + Objekti Nr.4- 4,106,613 lek pa TVSH (Linja e Ujit Piqeras shkall) ne total marre sebashku eshte = **21,559,903 lek pa TVSH > se vlera 27,760,558 lek pa TVSH** e dyfishit te fondit limit te prokuruar nga AK

Per me tepër ekziston dhe vendim i ngjashem me kete problematik nga K.P.P Nr. 282/2016

Sa më sipër, KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk vërteton se gëzon eksperiencë të mëparshme në përputhje me kriterin dhe kushtet e percaktuara ne piken b) te pikës 2.2.1. te “Kriterëve te Veçanta” te hartuar nga AK.

2. Per Piken 2.3.4

Per kete pike OE “COGREN” nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion per te vërtetuar se ka te punësuar nje specialist te kualifikuar **“Mekanik”** me te gjithë dokumentacionin e nevojshëm **(Kontrat pune + IQT ose ekuivalente)** te percaktuar ne kushtet e pikës 2.2.4

Per specialistin Besnik Selishtja **“Saldator”** OE ka paraqitur vetëm deshmine e sigurmit teknik dhe asnje dokument si **“Kontrat Pune”** per te vërtetuar se ky specialist eshte ne marrëdhënie pune

me OE, per me tepër ky specialist nuk figuron ne te gjitha litespagesat per **periudhën e muajve Janar- Korrik 2020**

3. Per Piken 2.3.6

Per Mjetin “Sonde shpimi” me targ AC MT 19 rezulton se i kane **mbaruar** vlefshmeria e dokumentacionit “Siguracion” me date 2.07.2020 ne **kundërshtim me kërkesat e pikës 2.2.6**, ku dokumentacioni duhet te jete i vlefshëm brenda datës se hapjes se dokumentave.

Nga sa me siper dhe ne mbeshtetje te Ligji te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Nenit 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “COGREN” shpk, nuk eshte e suksesshme, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.

2. Operatori Ekonomik K.M.K shpk

Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

1. Per Piken 2.2.1

Nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga OE “K.M.K” shpk rezulton se:

Shoqeri “K.M.K” shpk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 2.2.1, per pune te ngjashme vetëm per Objektet, 1 Rehabilitim Kanalesh Ujitese Diber . 2. Ujesjllsin Peqin 3. Venia ne pune e rrjetit ujësjellësit zona Selit...., Kontrat U.K Tirane dhe te gjitha objektet e tjera janë punime rrugësh, punime elektrike kabinash etj, te cilat nuk kane per natyre te objektit, objektin e prokuruar nga Autoriteti Kontraktor.

Nga sa me sipër KVO argumenton se nisur nga objektet e me sipërme per te cilat janë paraqitur dokumentacion, nuk janë te ngjashem me objektin e prokuruar nga AK, per me tepër ne asnjë prej punëve te paraqitur nga OE nuk ka as edhe nje ze te vetëm te ngjashem me “Shpim Pusi” apo shpime te llojeve te ndryshme ne thellësi per te provuar se OE gëzon eksperienca te meparshme per realizimin e këtij punimi. Zeri “Shpime Pusi”, nisur dhe nga titulli qe ka marre objekti jone, i cili ka perpare sine kryesore nga gjithë titujt e punimve te prokuruar gje qe kerkone eksperience te me pareshme te ngjashme si garanci per funksionimin pa probleme per vite me radhe te këtij stacioni, i cili do te sherbej per furnizimin me uje te qytetit te Sarandes.

Per me tepër ju sugjerojmë te lexoni dhe Vendimin e K.P.P Nr.328/ 2020 per te kuptuar me qart argumentin e K.V.O, per te cilen qe K.P.P-ja ka marre vendim per te njeten procedure te anuluar me pare nga AK.

Sa më sipër, KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk vërtetohet se gëzon eksperiencë të mëparshme në përputhje me natyrën dhe me volumnin e punës së ngjashme të objektit të prokuruar nga AK .

2. Per Piken 2.3.6

Per Mjetin “ Kompresor per thithjen dhe largimin e llumrave” me targe AA390JS rezulton se i kane **mbaruar** vlefshmeria e dokumentacionit “Siguracion” me date 26.07.2020 dhe “Kontrolli teknik S.G.S” 20.08.2020, ne **kundërshtim me kërkesat e pikës 2.2.6**, ku dokumentacioni duhet te jet i vlefshëm brenda datës se hapje se dokumentave.

Nga sa me siper dhe ne mbeshteje te Ligji te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Nenit 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “K.M.K” shpk, nuk eshte e suksesshme, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.

Duke u nisur nga sa me siper renditja e operatoreve ekonomik eshte si me poshte:

- | | |
|--------------------------------------|---------------------|
| 1. “COGREN” shpk Nipt. J74818825K | Skualifikuar |
| 2. “MANE/S” shpk Nipt. J64103865K | Kualifikuar |
| 3. “Shendelli” shpk Nipt. K07924803N | Kualifikuar |
| 4. “K.M.K” shpk Nipt. L78223801E | Skualifikuar |

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë : Shoqerine “MANE/S” Sh.p.k, NIPT J64103865K, me adresë : Sarande, Lagjia nr. 2, P. 46 , se oferta e paraqitur, me vlere 9,404,900(nentemilion katerqind e katermije e nenteqind)leke (pa TVSH)

është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ujesjelles Kanalizime sh.a Sarande* kopjen e sigurimit të kontratës, si dhe te paraqiteni per nenshkrimin e kontrates, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë **05.10.2020**

Ankesa : Nuk ka patur